



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.315/1.prot.

Peshkopi, më 15.04.2022

Lënda : Per vendimin nr. 16, datë 08.04.2022 të Këshillit të Bashkise Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.16, date 08.04.2022 “Për miratimin e kalendarit orientues hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, vendosa :

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në atë fushë të së drejtës, veprime që kurdoherë janë përgjegjësive direkte administrativo-ligjore e strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt-akte të kësaj natyre.

PREFEKTI  
Nexhibedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 1157 Prot

Peshkopi, më 13.04.2022

**Lënda:** Dërgim i Vendimeve për konfirmim

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër

*Adresa: Bulevardi "Eles Isufi"*

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" po ju dërgojmë për konfirmim ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak Dibër më datë 08.04.2022

Bashkëngjitur do të gjeni vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 16 date 08/04/2022 "Për miratimin e kalendarit orientues hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025"

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Afrim Mikli**



*Kapja*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 16 Date 08/04/2022

**“Për miratimin e kalendarit orientues hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”**

Në zbatim të ligjit nr.57/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”:

Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës 08.04.2022 miratoi me 19 vota pro, 0 kunder ,0 abstenim.

**VENDOSI:**

- 1- Miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Dibër.
- 2- Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjithë drejtoritë dhe sektorët e institucionit të Bashkisë Dibër.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

**KRYETAR KËSHILLI**  
**Sokol SAVA**





PERIUDHA

DATA

INSTITUCIONI/PERSONI PËRLEGJES

VEPRIMI PERKATES

|                |                        |   |   |
|----------------|------------------------|---|---|
| Dhjetor        | Brenda muajt dhjetor   | Kryetari i NJQV-së                        | Përgatit dhe paraget në Këshillin Bashkiak Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm  |
| Dhjetor        | Deri - 31 Dhjetor      | Këshilli i Njësive Vendore                | Shqyrton dhe miraton Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm  |
| Janar          | 15                     | Kryetari i NJQV-së                        | Kryetari shpërndan kalendarin e programit buxhetor afatmesëm tek të gjitha njësitë shpenzuese                                 |
| Janar          | 31                     | Kryetari i NJQV-së                        | Kryetari i njësitë paraget për shqyrtim dhe miraton raportin e vlersimit të të ardhurave dhe shpenzimeve                      |
| Mars           | 1                      | Këshilli i Njësive Vendore                | Miraton raportin e vlersimit të të ardhurave dhe shpenzimeve  |
| Mars           | Brenda dates 15        | Kryetari i NJQV-së                        | Paraget për miratim në Këshillin e NJQV-së tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA  |
| Mars           | 15                     | Këshilli i Njësive Vendore                | Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm  |
| Mars           | 20                     | Kryetari i NJQV-së                        | Miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësite vendore dhe e shpërndan tek njësite shpenzuese                         |
| Mars - Prill   | 21 Mars -25 Prill      | Njesite shpenzuese të bashkisë            | Përgatitnin kërkesat e tyre buxhetore   |
| Mars - Prill   | 26 Prill - 27 Prill    | Njësia e vetëqeveritjes vendore           | Zhvillojnë takime konsultative me shoqëritë civile dhe grupet e interesit për PBA 2023-2025                                   |
| Mars - Prill   | 28 Prill - 30 Prill    | Njësité shpenzuese të Bashkisë            | Njësité shpenzuese paraguesin në bashki kërkesat e përgatitura  |
| Maj            | 1 Maj - 15 Maj         | Njësia përgjegjëse për buxhejin në bashki | Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore  |
| Maj            | 16 Maj - 26 Maj        | Kryetari i NJQV-së                        | Organizon seancat dëgjimore me Banorët  |
| Maj            | 27 Maj - 29 Maj        | Kryetari i NJQV-së                        | Prezanton dokumentin e PBA 2023-2025 me shoqëritë civile  |
| Maj            | 30 Maj - 31 Maj        | Njësia përgjegjëse për buxhejin në bashki | Pepilon draftin e fazës së parë të PBA-së 2023-2025   |
| Qershor        | 1                      | Kryetari i NJQV-së                        | Dërgon pranë Ministrisë së Financave projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm   |
| Qershor        | Deri - 20              | Ministria e Financave                     | Dwrgon komente një raport me mendime mbi projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm                                     |
| Qershor        | Deri -25               | Njësia përgjegjëse për buxhejin në bashki | Reflektion komentet e Ministrisë së Financave   |
| Qershor        | Deri - 30              | Këshilli i Njësive Vendore                | Shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm   |
| Korrik         | Deri - 5 Korrik        | Kryetari i NJQV-së                        | Merr masat për publikimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm   |
| Korrik         | Deri - 20 Korrik       | Këshilli i Njësive Vendore                | Miraton tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm   |
| Korrik         | 25                     | Kryetari i NJQV-së                        | Miraton udhëzimin plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe shpërndan tek njësitë shpenzuese               |
| Korrik - Gusht | 26 Korrik-31 Gusht     | Njësité shpenzuese të bashkisë            | Përgatitnin kërkesat buxhetore të rishikuara  |
| Shator         | 1                      | Njësité shpenzuese të bashkisë            | Njësité shpenzuese paraguesin në bashki kërkesat buxhetore të rishikuara  |
| Shator         | 2 Shtator - 14 Shtator | Njësia përgjegjëse për buxhejin në bashki | Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore  |
| Shator         | Deri - 15              | Kryetari i NJQV-së                        | Dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar                                       |
| Shator-Tetor   | Deri 5 Tetor           | Ministria e Financave                     | Organizohen seanca konsultimi me njësitë e vetëqeveritjes vendore   |
| Tetor          | Deri - 20 Tetor        | Ministria e Financave                     | Sipas rasisit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të PBA              |
| Tetor-Nentor   | 6 Tetor -30 Nentor     | Njësia përgjegjëse për buxhejin në bashki | Përgatitn Projektbuxhetin e vitit 2023 siç dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2023-2025 dhe t'parqet për shqyrtim në kryetari |
| Dhjetor        | 25                     | Këshilli i njësitë vendore                | Miraton programin buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe buxhejin vijtor   |
| Dhjetor        | 31                     | Kryetari i NJQV-së                        | Merr masat për publikimin dokumentin e plotë të programit buxhetor afatmesëm  |